



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

PROJETK RREGULLORE NR. X/2023 PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E DOSJES ELEKTRONIKE TË GJYQTARËVE

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt - rregullore synon të rregullojë përdorimin, administrimin dhe qasjen në Sistemin e Dosjes Elektronike të Gjyqtarëve. Ky sistem ka për qëllim kryesor krijimin e një baze të dhënash elektronike për secilin gjyqtar të emëruar në sistemin gjyqësor, duke filluar nga procesi i rekrutimit e deri në përfundimin e mandatit.

Në veçanti, rregullorja përcakton mënyrën e krijimit, përditësimit dhe administrimit të dosjes elektronike të gjyqtarëve, modulet përkatëse të sistemit që mbulojnë fusha si emërimet, trajnimet, vlerësimin e performances dhe disiplinën.

	<p>Projekt rregulloja poashtu përcakton autorizimet dhe përgjegjësitë e secilit përdorues sipas profilit, masat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave dhe procedurat e auditimit dhe përgjegjësitë në rast të shkeljeve.</p> <p>Në përgjithësi projekt rregullorja ka për qëllim krijimin e një rregullative nënligjore për përdorimin dhe administrimin e dosjes elektronike, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe transparencja në menaxhimin e të dhënave të gjyqtarëve.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Arsyeja e hartimit të projekt Rregullore X/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Gjyqtarëve është jetësimi i planeve strategjike dhe planeve të punës së Këshilli Gjyqsor të Kosovës për krijimin e Sistemit Elektronik të Dosjesë së gjyqtareve.</p> <p>Permes hartimit të kësaj projekt rregullore synohet të rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse funksionimi i Sistemit Elektronik të Dosjeve të Gjyqtarëve si një mjet modern dhe efikas i administrimit të burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor.</p>

	<p>Rregullorja po ashtu synon të siguroj ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen të dhënave personale të gjyqtarëve dhe informacionit në përputhje me legjislacionin.</p> <p>Hartimi i kësaj rregullore është i domosdoshëm për disa arsye:</p> <p>Së pari, krijimi i një sistemi elektronik për dosjet e gjyqtarëve është në përputhje me standardet ndërkombëtare për infrastrukturën dixhitale në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Së dyti, ky sistem elektronik i centralizuar rrit efikasitetin administrativ dhe menaxherial në procesin e administrimit të të dhënave të gjyqtarëve..</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Draftit të Rregullore X/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Gjyqtarëve.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo</p>

	<p>sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 5 dhjetor 2023.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>